# Rregullat e Tregtimit Intraday (Brenda Ditës)

## Rregullat e Tregtimit - Shtojca 3

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike

# 1. HYRJE

1.1 Tregu Brenda Ditës është një treg për Tregtimin e vazhdueshëm të Produkteve gjatë Oreve të Tregtimit, ku Transaksionet janë përputhur automatikisht kur Porositë konkurruese janë regjistruar në ETS. Transaksionet mund të bëhen deri në një orë para livrimit.

1.2 Këto Rregullore të Tregut Brenda Ditës përmbajnë dispozita të detajuara mbi Porositë dhe Transaksionet në Tregun Brenda Ditës dhe janë pjesë e Rregullave të Tregtimit.

1.3 Produktet e tregtueshme në Tregun Brenda Ditës dhe Orët që zbatohen për Tregtimin e tyre, janë listuar të Specifikimet e Produktit, (Shtojca 1).

# 2. RENDITJA

## 2.1 **Kuotimi**

2.1.1 Porositë duhet të jenë vetëm të Tipeve të Porosive të lejuara nga Specifikimet e Produktit, dhe duhet të lidhen me një Produkt të specifikuar.

2.1.2 Çmimet e Porosive do të tregojnë çmimin në Euro për MWh. Për shembull, një porosi e kuotuar 22.60 do të thotë që Çmimi i Porosisë është 22.60 Euro për MWh.

2.1.3 Volumi i Porosisë tregon volumin maksimal për tu blerë apo shitur në MWh.

2.1.4 Një Porosi do të specifikojë informacionin e mëposhtëm me qëllim që të jetë i vlefshëm:

a. Për Pjesëmarrësin që e bën Porosinë;

b. Nëse Porosia është një Kërkesë apo një Oferte;

c. Për Tipin e Porosisë në fuqi;

d. Për Kodin e Kontratës në fuqi;

e. Për Kufirin e Volumit të Energjisë në fuqi (në MW);

f. Për Kufirin e Çmimit të Porosisë në fuqi (në Euro/MWh); dhe

g. Nëse është e aplikueshme dhe/ose të dëshirueshme: Çdo informacion shtesë, siç është mandatuar dhe/ose lejuar nga (i) Rregullat e Tregtimit (duke përfshirë Rregullat e Sjelljes së Tregut) dhe/ose (ii) funksionimin mbizotërues të ETS.

2.1.5 Një Porosi do të jetë e vlefshme nga koha e regjistrimit, në përputhje me Nenin 2, dhe derisa ajo të përputhet, hiqet apo ndryshohet ashtu siç specifikohet në Nenet 2.3 apo 3, apo ka skaduar ashtu siç specifikohet në Porosi.

## 2.2 **Renditja e Porosive**

2.2.1 Porositë janë renditur si me poshtë:

a. Porositë janë renditur sipas Çmimit të Blerjes;

b. Porositë me të njëjtin Çmim Porosie janë renditur, bazuar në faktin se cila Porosi është regjistruar e para në ETS;

2.2.2 Bllok Porositë që nuk mund të përputhen mund të anashkalohen nga Porosi të renditura si më pak të rëndësishme të cilat mund të përputhen.

## 2.3 Regjistrimi i Porosive dhe Përputhja

2.3.1 Porositë do të dërgohen në Bursën Shqiptare të Energjisë nëpërmjet ETS. Transaksionet janë përputhur automatikisht sapo Porositë konkurruese janë regjistruar në ETS. Transaksionet që rezultojnë nga Porosi që janë përputhur në ETS, janë automatikisht në mënyrë të detyrueshme të regjstruara për shlyerje (pagesa).

2.3.2 Ndryshimet apo anullimet e një Porosie në ETS bëhen të vlefshme kur regjistrohen në ETS, me kusht që Porosia nuk ka qenë në përputhje sipas Nenin 2.3.1 nga koha e regjistrimit të ndryshimit apo anullimit.

2.3.3 Në situatat kur ETS nuk funksionon ose nuk është i aksesueshëm nga Pjesëmarrësit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të aprovojë që Pjesëmarrësi mund ti telefonojë Porositë, apo ndryshimet apo anullimet e Porosive ashtu siç është përcaktuar më tej në Termat e Përgjithshme të këtyre Rregullave Tregtimi.

2.3.4 Në rast të një pezullimi të përgjithshëm të Tregtimit, të gjitha Porositë në ETS do të ç'aktivizohen automatikisht. Me kthimin në operacione normale, Pjesëmarrësit do të duhet të ri-aktivizojnë të gjithë Porositë nga gjendja e tyre joaktive. Porositë të cilat janë të pa-aktivizuara nga fundi i ditës përkatëse të Tregtimit do të hiqen.

2.3.5 Balanca e Hapur në Prodhim do të livrohet në rrjetin kryesor të Zonës Brenda Ditës, ku Mbajtësi i Llogarisë është regjistruar në përputhje me rregullat për shlyerjet e disbalancave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në zonën e veçantë.

# 3. GABIMET E TREGTIMIT

3.1.1 Pjesëmarrësit të cilët dëshirojnë të anullojnë një Transaksion si rezultat i një Gabimi Tregtar, duhet të përdorin funksionalitetin e fshirjes së tregtimit në ETS, jo më vonë se pesë (5) minuta pas Kohës së Kontratës për Transaskionin përkatës.

Nëse anullimi nuk është i mundur në ETS, pjesëmarrësi duhet të lajmerojë me një Kërkesë për anullim Tryezën e Tregtimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike nëpërmjet telefonit sa me shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se pesë (5) minuta pas Kohës së Kontratës për Transaksionin përkatës.

3.1.2 Asnjë Kërkesë për një Gabim Tregtimi nuk mund të ngrihet në lidhje me një Transaksion dhe çdo Kërkesë për një Gabim Tregtimi do të jetë e pavlefshme:

a. Nëse kërkesa është bërë më vonë se afati i përcaktuar në Nenin 3.1.1;

b. Nëse kërkesa është bërë më vonë se njëzetë (20) minuta para përfundimit të Tregtimit për Produktin në fuqi.

3.1.3 Pas marrjes së një Kërkese për anullim, në përputhje me Nenin 3.1.1, procedurat e mëposhtme do të aplikohen:

a. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të vendosë mbi bazën e përpjekjeve më të mëdha dhe në diskrecionin e saj të vetëm, një çmim të arsyeshëm reference të tregut për Serinë përkatëse të Produktit në kohën e Kontratës të Transaksionit përkatës. Çmimi i referencës së tregut do të përcaktohet në bazë të informcionit në dispozicion të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, duke përfshirë:

(i) Çmimin e transaksionit paraardhës për produktin përkatës;

(ii) Porositë e regjsitruara në ETS;

(iii) Paqëndrueshmërinë;

(iv) Çmimin e Transaksioneve të konkluduara duke konsideruar Periudhën e Kontratës të Transaksionit përkatës;

(v) Nëse informacioni në dispozicion të tregtimit është i kufizuar në ETS; çdo informacion tjetër të tregut që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike e konsideron relevant për të përcaktuar një çmim të drejtë reference të tregut për produktin përkatës.

b. Çmimi i referencës së Tregut i përcaktuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas gërmës “a” të nenit 3.1.3, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do ti shtojë Marxhinat e Devijimit prej +/- 50% (pesëdhjet për qind) kundrejt Çmimit të referencës së Tregut.

c. Nëse Çmimi i Kontratës në Transaksionin përkatës është jashtë Marxhinave të Devijimit, Transaksioni përkatës do të anullohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike. Çdo anullim është subjekt i disponueshmërise së kapacitetit të transmetimit në rast se tregtitë ndërkufitare janë përfshirë.

3.1.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike rezervon të drejtën, edhe nëse kushti në paragrafin 3.1.1-3.1.3 është plotësuar, të refuzojë një kërkesë për anulim, nëse për shkaqe teknike ose operacionale Shkëmbimi Shqiptar i Energjisë nuk është në gjendje të anulojë efektivisht transaksionin.

3.1.5 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund, nëse çmimi i kontratës së një Transaksioni është jashtë Marxhinit të Devijimit, të iniciojojë një proces konsultimi me palët e përfshira, në përputhje me nenin 3.1.3.

3.1.6 Palët në transaksionin përkatës do të mbeten anonimë gjatë diskutimeve, siç parashikohet në këtë nen.

3.1.7 Pas anulimit të suksesshëm Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë tregun me anë të një mesazhi për tregun në ETS se transaksioni është anulluar.

3.1.8 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike duhet brenda pesëmbëdhjetë (15) minutash nga regjistrimi i transaksionit në ETS, të anullojë të gjitha transaksionet që përfshijnë gabime të regjistrimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, qoftë nga pakujdesia apo nga shkaqe të tjera. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë menjëherë tregun përmes ETS që transaksioni është anulluar, dhe do të regjistrojë një Transaktion të ri në kushtet e duhura.

3.1.9 Një pagesë shërbimi, e specifikuar në listën e çmimeve të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, do të paguhet për çdo Kërkesë anullimi të bërë ndaj Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, pavarësisht nëse kërkesat çojnë në anullimin e transaksionit apo jo.

## 4. PEZULLIMI I TREGTIMIT

4.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të pezullojë Tregtimin në ETS nëse Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike beson se është e nevojshme, nëse ka gabime teknike apo mirëmbajtje në ETS apo problem në sistemet elektrike.

4.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike duhet deri në masën e mundshme të informojë Pjesëmarrësit për pezullimet.

4.3 Të gjithë Porositë në ETS do të ç'aktivizohen automatikisht përpara se ETS të rihapet, por do të mbeten të ruajtura në ETS për aq sa kjo është teknikisht e mundur, duke aplikuar përpjekje tregtare të arsyeshme.

## 5. SITUATAT E NDËRPRERJEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

5.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund që në kushtet e një situate kombëtare të ndërprerjes së Energjisë Elektrike, ashtu siç përcaktohet nga OST- të përkatëse, të pezullojë Tregtimin dhe/ose anullojë një apo më shumë Porosi apo Transaksione.

5.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike duhet që menjëherë pas marrjes së informacionit të problemeve nga ana e OST-së, të njoftojë pjesëmarrësit për kohëzgjatjet e vlerësuara nëpërmjet njoftimit elektronik në ETS ose me mjete të tjera që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike i shikon të arsyeshme.

5.3 Situatat problematike në sistemet elektrike që përfshijnë palët e vetme nuk do të kenë një efekt mbi detyrimet fikse të livrimeve të Energjisë Elektrike apo Transaksioneve të konkluduara nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike. Pala do të përmbushë detyrimet e veta kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, pavarësisht situatës së krijuar. Pasojat e një situate problematike do të mbeten për tu paguar ndërmjet palës dhe mundësisht iniciuesit të problemeve ashtu si edhe Furnitorit të Hapur të Palës.

5.4 Tregtimi në Tregun e Ditës Përpara do të mbahet i hapur edhe nëse ka ç'rregullime në sistemin e Energjisë Elektrike që ndikojnë transferimin, konsumin apo prodhimin e Energjisë elektrike nga ana e një pale të vetme.

## 6. INFORMACIONI I TREGUT

6.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të furnizojë Pjesëmarrësit përgjatë çdo Dite Tregtimi, me informacion për të gjithë Porositë dhe Transaksionet e regjistruara në ETS, mbi baza anonime. Një informacion i tillë transaksionesh do të bëhet disponibël nëpërmjet ETS-së ku Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në gjykimin e vetë vendos që kompensimi për një informacion të tillë është përfshirë në tarifat e anëtarësimit.

6.2 Informacioni i Transaksionit do të përfshijë informacion mbi çmimet dhe volumet e Porosive dhe Transaksioneve, renditjen e Porosive, Kohën në të cilën një Transaksion është kryer dhe çdo anullim apo ndryshim të Transaksioneve.

6.3 Shkëmbimi i informacionit mund të bëhet vetëm midis Pjesëmarrësit të Tregut dhe Operatorit të Tregut, dhe anasjelltas ose Operatorit të Tregut dhe Pjesëmarrësve të Tregut, në një faze të mëvonshme, megjithatë nuk duhet të lejohet që informacioni i ndjeshëm tregtar të lejojë identifikimin e Pjesëmarrësit të Tregut.

6.4 Sistemi i Operimit të Tregut, ndër të tjera, do të mundësojë një shkëmbim on-line të informacionit sa më sipër përmendur.